

V E N D I M
Nr.311, datë 11.7.1994

PËR PËRFITIMIN E PAAFTËSISË

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, duke u mbështetur në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Gjithë personat e lindur të paaftë ose që janë bërë të tillë para moshës 16 vjeç, të vërtetuar nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP) pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me gjendje shëndetësore të invaliditetit të grupit të parë dhe të dytë sipas kriterëve për përcaktimin e aftësisë për punë të invalidëve të vitit 1991, marrin përfitim paaftësie.

2. Pagesa e përfitimit të paaftësisë bëhet një herë në muaj, duke filluar nga muaji pasardhës pas datës që komisioni i përcaktuar në pikën një të këtij vendimi vërteton paaftësinë.

3. Përfitimi i paaftësisë është i barabartë në vlerë me ndihmën ekonomike për familjet me një anëtar.

4. Gjithë të paaftët sipas pikës 1 të këtij vendimi që kanë punuar në ndërmarrje shtetërore jo më pak se pesë vjet, që kanë humbur vendin e punës pas 1 janarit 1991 dhe që aktualisht nuk përfitojnë pension invaliditeti sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, marrin përfitim paaftësie 150 për qind të vlerës së përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Përfitimi i paaftësisë konsiderohet si e ardhur personale dhe si e tillë nuk llogaritet në të ardhurat e familjes që përfiton ndihmë ekonomike në bazë të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”.

6. Humbasin të drejtën e përfitimit të paaftësisë gjithë ata që hyjnë në marrëdhënie pune.

Gjithashtu, nuk marrin përfitim paaftësie personat e vendosur në qendra rezidenciale riaftësuese publike, për aq kohë sa qëndrojnë në këto qendra.

7. Këshilli i bashkisë ose i komunës, kur e gjykon të domosdoshme, ka të drejtë që, me propozimin e administratorit social, t’u japë ndihmë ekonomike familjeve që kujdesen për një person me aftësi të kufizuara fizike, sensore a mendore pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, edhe kur ky person nuk plotëson kriteret e pikës 1 të këtij vendimi.

Masa e ndihmës që mund t’i jepet familjes në këto raste, është deri në nivelin e përfitimit të paaftësisë që merr një person sipas pikës 3 të këtij vendimi.

8. Fondet për përfitimin e paaftësisë dhe për ndihmën ekonomike për shkak paaftësie janë në administrim të pushtetit lokal.

9. Shpenzimet që kryen Instituti i Sigurimeve Shoqërore për pagesën e komisionimit nga KMCAP të të paaftësive sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

10. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 1994 shpenzimet për përfitimin e paaftësisë dhe ndihmën ekonomike për shkak paaftësie me një efekt prej 115.5 milionë lekësh të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi